



Niveli Vendor në një Vështrim SHQIPËRIA

POGRADEC

Qershor 2020

Në shkurt të vitit 2018, u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit si një marrëveshje trepalëshe midis Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Pogradec. U caktua një pikë kontakti e bashkisë për programin ROMACTED nga Kryetari i bashkisë për të ofruar mbështetje dhe për të lehtësuar procesin e zbatimit të programit në nivel bashkie.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, në Pogradec u ngritën zyrtarisht Grupi Komunitar i Veprimit (GKV), Grupi Institucional i Punës (GIP) dhe Grupi i Task-Forcës së Bashkisë (GTB).

Arritjet kryesore

DOKUMENTET VENDORE TË PËRGATITURA NË KUADRIN E ROMACTED

- Sondazhi për situatën bazë dhe kriteret përzgjedhëse të bashkisë;
- Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë - informacione të mbledhura për nevoja të administratës vendore për t'iu përgjigjur si duhet nevojave të komunitetit;
- Vlerësimi i Nevojave në Nivel Komuniteti - identifikimi dhe njohja e karakteristikave të komunitetit rom, nevojave, mundësive dhe kërkesave të tyre;
- Hartëzimi i Aktorëve të Interesuar - identifikimi i aktorëve të interesuar të të gjitha niveleve me qëllim krijimin e strukturave dhe sinergjive vendore;
- Hartimi i Listës së Prioriteteve të Komunitetit - janë identifikuar gjithashtu masat, mënyrat dhe aktorët, që kontribuojnë në arritjen e përbushjes së nevojave kryesore;
- Hartimi i Planit Vendor të Veprimit - përkthimi i nevojave në aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të dakordësuara mes anëtarëve të Grupit të Task-Forcës së Bashkisë;
- Llogaritja e kostove të aktiviteteve të Planit Vendor të Veprimit - duke marrë parasysh afate të parashikuara, numrin e aktiviteteve dhe numrin e përfituesve, gjë që ndihmon autoritetet vendore në planifikimin e buxhetit dhe në buxhetimin afatmesëm;
- **Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022**, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec Nr. 22, datë 28 janar 2020.

NGRITJA E KAPACITETEVE



Gjashtë anëtarë të GTB (tre anëtarë të GKV-së dhe tre anëtarë të GIP-së) u trajnuan për "Planifikimin Strategjik Vendor me Pjesëmarrje" gjatë vitit 2018 dhe për "Hartimin e Planeve të Përbashkëta të Veprimit për Integrimin e Romëve në Nivel Vendor" gjatë vitit 2019. Gjatë vitit 2020 u trajnuan gjashtë pjesëmarrës të Task Forcës së Bashkisë për "Buxhetimi me Përgjegjshmëri Rome në Nivel Vendor".

STREHIMI DHE INFRASTRUKTURA

- 44 familje rome dhe egjiptiane u bënë pjesë e projektit të rindërtimit të shtëpive nga zonat e Starovës dhe Lagjes Nr. 4 në Pogradec. Grupi i vlerësimit ngritur nga Bashkia e Pogradecit përfshinte një anëtar të komunitetit rom;
- 16 familje rome kanë akses në ujin e rrjedhshëm në zonën e Kabashit si rezultat i masave afat-shkurtra të komunitetit të mbështetur nga Instituti I Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA);
- Janë ndërmarrë veprime avokimi për të trajtuar çështjen e dëbimit të 24 familjeve rome që jetojnë në zonën e Gurit të Kuq. Këto veprime përfshinin hartimin e letrave dhe organizimin e disa takimeve me përfaqësuesit e Bashkisë Pogradec, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Qysh atëherë, dhjetë familje në këtë zonë janë njohur si pronarët e apartamenteve pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë.



PUNËSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL




- 23 individë romë u regjistruan si punëkërkuës në Zyrën e Punës në Pogradec;
- 11 të rinj romë u regjistruan në Qendrën e Formimit Profesional për të ndjekur kurse për hidraulikë, elektrikë, panelet diellore dhe teknike kompjuterësh për të rritur aftësitë e tyre profesionale.

ARSIMI DHE DIALOGU NDËRKULTUROR

- 28 fëmijë romë e egjiptianë nga Kabashi, Guri i Kuq dhe Starova u regjistruan në shkollën fillore dhe të mesme. U rrit ndërgjegjësimi mes prindërve romë rreth rëndësisë së arsimit dhe iu dha informacion rreth regjistrimit në shkollë;
- Pas nismës së mbështetur nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, 62 nxënës romë nga shkolla "Amaro Tan" u informuan se do t'u jepeshin libra falas;
- Më 25 prill 2018, pjesa "Ena e Drunjtë" nga Edmund Morris u interpretua nga nxënësit romë me rastin e javës rome. Kjo u organizua edhe në kuadrin e veprimtarisë së prezantimit vendor, me qëllim nxitjen e rëndësisë së fuqizimit të komuniteteve rome dhe integritit të romëve në Bashkinë e Pogradecit. Veprimtaria u ndoq nga 110 anëtarë të komunitetit rom, përfaqësues të bashkisë dhe institucioneve vendore, shkollave vendore, Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë dhe Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA).



GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



Grupi i Task Forcës së Bashkisë ka anëtarë nga Bashkia e Pogradecit, shoqëria civile dhe nga institucione të tjera vendore përgjegjëse për përfshirjen e romëve. Takimet zhvillohen çdo tre muaj me mesatarisht 7-9 pjesëmarrës.

Dokumente Strategjike Vendore

Plani Vendor i Veprimit

Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 u hartua në bazë të konsultimeve me të gjithë aktorët vendorë të interesuar.

Ky plan adreson gjashtë prioritet kryesore:

- (i) aksesin e barabartë në regjistrin e gjendjes civile dhe drejtësi;
- (ii) arsim dhe promovimin e dialogut ndërkulturor;
- (iii) kujdesin mjekësor; punësimin dhe formimin profesional;
- (iv) strehimin dhe integrimin urban; dhe
- (v) mbrojtjen sociale.

Buxheti total i Planit të Veprimit 2019 – 2022 është 308,177,262 lekë. Ai u miratua me Vendim të Këshillit të Bashkisë Pogradec nr. 22, datë 28 janar 2020.

Projekte

Të zhvilluara në kuadër dhe/ose financiar prej programit

- Rindërtimi dhe rehabilitimi i urës së Kabashit, që lidh zonën e banuar me Pogradecin, financiar në kuadrin e skemës së ROMACTED për grante të vogla;
- Instalimi i çezmave të ujit në zonën e "Kabashit" u financua nga nisma komunitare në kuadrin e programit ROMACTED mbështetur nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri.

Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor

- Bashkëpunimi me organizatat vendore të shoqërisë civile rome dhe egjiptiane, Vëllazërinë Egjiptiane dhe Realitetin Rom në Shqipëri, të cilat ofruan kontribute gjatë përgatitjes së Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane;
- Koordinimi i masave me Klinikën Ligjore, që vepron në Rrethin Gjyqësor të Pogradecit, mbështetur nga fondacioni i Shoqërisë së Hapur për çështjen e strehimit në zonën e "Gurit të Kuq";
ërisë së Hapur për çështjen e strehimit në zonën e "Gurit të Kuq";

Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor

- Forcimi i sinergjisë me Bashkinë Pogradec dhe Prefekturë strehimit në lagjen e Kabashit;
- Bashkëpunimi me Institutin e Shëndetit Publik përmes ambulancave të lëvizshme në lagjet rome;
- Koordinimi mes shkollave profesionale, bizneseve private dhe organizatat e shoqërisë civile rome për mundësitë e të rinjve romë për kurse praktike.

Kontaktet

Kryetari i Bashkisë Pogradec: Z. Ilir XHAKOLLI

Pika e Kontaktit në Bashki: Znj. Valentina VESHOLLARI

Lehtësuesi e ROMACTED: Z. Olsi SHERIFI



Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor